

Përmbledhje

- **Ekonomia e eurozonës u tkurr në tremujorin e tretë të vitit 2023, duke shënuar rënie prej 0.1 përqind sipas Eurostat, e ndikuar nga inflacioni ende i lartë dhe rritja e normave të interesit.** Projektionet për rritje ekonomike në eurozonë nga BQE-ja sugjerojnë rritje reale të BPV-së prej 0.7 përqind për vitin 2023 dhe 1.0 përqind për vitin 2024. **Shkalla e inflacionit në TM3 2023 arriti në 4.9 përqind, duke shënuar ngadalësim kundrejt shkallës prej 9.3 përqind të shënuar në TM3 2022.** Përderisa inflacioni ra ndjeshëm në tetor, në takimin e BQE-së të mbajtur më 26 tetor 2023, normat e interesit u mbajtën të pandryshuara, ndërkohë që vendimet e radhës u deklaruan se do të jenë subjekt i të dhënave/dinamikave makroekonomike. Projektionet e BQE-së sugjerojnë një ngadalësim të inflacionit në 5.6 përqind në 2023, dhe 3.2 përqind në vitin 2024.
- **Aktiviteti ekonomik në Kosovë në TM3 2023 vlerësohet se ka shënuar rritje reale prej 3.0 përqind,** rritje që kryesisht i është atribuar kontributit pozitiv të konsumit dhe investimeve, ndërsa eksportet neto kontribuuan negativisht në rritjen reale të BPV-së. Konsumi rezultoi të ketë shënuar rritje më të lartë, ndërkohë që rritja e investimeve është përcaktuar kryesisht nga rritja e investimeve publike. Për TM4 2023, BQK vlerëson se aktiviteti ekonomik shënoi rritje më të lartë krahasuar me tremujorët paraprak duke bërë që viti 2023 të përmbyllet me rritje të BPV-së prej 3.4 përqind. Rritja në TM4 2023, vlerësohet se është mbështetur nga investimet e përgjithshme, konsumi publik si dhe eksporti i shërbimeve, ndërsa vlerësimet për rënie të eksportit të mallrave pritet të ndikojnë negativisht aktivitetin e përgjithshëm ekonomik.
- **Inflacioni vazhdoi të ndjekë trend ngadalësimi në TM3 2023 duke shënuar rritje vjetore prej 3.2 përqind** si rezultat i efektit të bazës, lehtësimeve në zinxhirët e furnizimit dhe çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Rritje e ngadalësuar u evidentua në një pjesë të madhe të komponentëve në shportën e konsumit, ndërsa çmimet e energjisë ndoqën prirje rritëse krahasuar me tremujorin paraprak. Ngjashëm, edhe inflacioni bazë shfaqti shenja ngadalësimi në TM3 2023 megjithëse dinamikat përgjatë tremujorit shfaqën luhatje. Sipas projeksioneve të BQK-së, inflacioni pritet të vazhdojë trendin e ngadalësimit dhe të arrijë në 3.0 përqind në vitin 2024.
- **Buxheti i Kosovës në TM3 2023 shënoi bilanc pozitiv buxhetor,** përkundër rritjes më të lartë të shpenzimeve buxhetore krahasuar me të hyrat, ndërsa borxhi publik u ul në 16.8 përqind të BPV-së, krahasuar me 20.5 përqind në TM3 2022. Përmirësimi i bilancit buxhetor të qeverisë që vjen kryesisht nga rritja e të hyrave dhe rritja e BPV-së nominale, që zvogëlon raportin e borxhit ndaj BPV-së, kanë qenë faktorët kryesor që kanë ndikuar në rënien e nivelit të borxhit publik.
- **Llogaria rrjedhëse gjatë TM3 2023 arriti në 223.3.7 milionë euro (121.9 milionë euro në periudhën TM3 2022).** Dinamikat në llogarinë rrjedhëse në TM3 2023 vazhduan të përcaktohen kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të mallrave. Në kuadër të llogarisë rrjedhëse, një ndër burimet më të rëndësishme financuese të konsumit, remitencat, shënuan rritje prej 7.2 përqind, duke arritur në 374.2 milionë euro. Ndërsa, investimet e huaja direkte gjatë TM3 2023 rezultojnë të kenë shënuar rënie prej 14.5 përqind, duke arritur vlerën prej 245.2 milionë euro.
- **Sistemi financiar në vend është zgjeruar me ritëm të lartë për të tretin vit me radhë, ndërkohë që dinamikat në vitin e ardhshëm pritet të jenë subjekt i zhvillimeve të përgjithshme makroekonomike dhe kapacitetit të ngritjes së fondeve (rritjes së depozitave).**
 - **Sektori bankar** ndër vite ka siguruar nivel të lartë të kapitalizimit, likuiditetit, dhe cilësi të lartë të aseteve (kredive). Niveli i kapitalizimit përtej kërkesave rregullatore e bën sektorin më të qëndrueshëm ndaj pasigurive të shkaktuara nga krizat gjeopolitike, rritja e inflacionit dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik. Aktiviteti kreditues kishte kontributin kryesor në rritjen e aseteve të sektorit bankar, pasuar nga investimet në letrat me vlerë. Banka Qendrore Evropiane nuk ka rritur më tej normat bazë të interesit, e që është tregues i frenimit të inflacionit, i cili pritet të ketë një rritje të lehtë dhe pastaj rënie graduale në vitin 2024, kurse në vitin 2025 pritet të bie në nivelin e rekomanduar (nën 2.0 përqind). Këto zhvillime në politikën monetare të BQE-së do të ndikojnë edhe në normat e interesit të aplikuara nga bankat vendore, të cilat nëse nuk ulen, pritet që të mos rriten më tej.
 - **Sektori pensional** u rikthye në ritmin e përshpejtuar të rritjes, pas ngadalësimit të theksuar një vit më parë që ishte pasojë e luhatjeve në tregjet financiare. Të dy fondet pensionale shënuan kthim pozitiv nga investimet në tregjet e jashtme dhe rritje të kontributeve të arkëtuara.
 - Aktiviteti i **sektorit të sigurimeve** shënoi rritjen më të lartë në pesë vitet e fundit, dhe u karakterizua me rritje të primeve të shkruara, e reflektuar edhe në performancë pozitive financiare. Sidoqoftë, cilësia e aseteve, kapitalit dhe disa nga treguesit kyç kanë nevojë për përmirësim më tutje për nivele më të kënaqshme mbi kërkesat rregullatore.
 - **Sektori mikrofinanciar** shënoi rritje të përshpejtuar, kryesisht ndikuar nga zgjerimi i kreditimit dhe lizingjeve, si dhe rritja e kapitalit vetanak. Sektori realizoi fitim pothuajse të ngjashëm me vitin paraprak, ndërsa ruajti cilësinë e portfolios kreditore dhe siguroi nivel të lartë të provizionimit të kredive jo-performuese.

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FAO	Food and Agriculture Organization (Organizata për Bujqësi dhe Ushqim)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
MMBTU	Metric Million British Thermal Unit
WEO	World Economic Outlook


Përmbajtja

Përmbledhje	0
Lista e shkurtesave	1
1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	3
2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare	4
3. Ekonomia e Kosovës	6
3.1. Rritja Ekonomike	6
3.2. Çmimet	7
3.3. Sektori Fiskal	9
3.4. Sektori i jashtëm	10
4. Sistemi financiar	14
4.1. Sektori bankar	14
4.2. Sektori pensional	22
4.3. Sektori i sigurimeve	23
4.4. Sektori mikrofinanciar	24
4.5. Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës	27

1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia e eurozonës u tkurr për 0.1 përqind në tremujorin e tretë të vitit 2023, ngadalësim i ndjeshëm nga rritja prej 0.2 përqind e regjistruar në tremujorin e mëparshëm. Rritja e pasigurive rreth perspektivës ekonomike dhe rritja e kostos së jetesës si pasojë e shkallës së lartë të inflacionit dhe rritjes së normave të interesit rezultojnë të ketë ndikuar në rënien e kërkesës për mallra dhe shërbime. Gjermania, ekonomia më e madhe e eurozonës, shënoi rënie të aktivitetit ekonomik prej 0.1 përqind e ndikuar nga rënia e eksportit. Rënia e eksportit në ekonominë e Gjermanisë u ndikua nga frenimi i rritjes ekonomike globale që ndikoi në uljen e kërkesës për mallra dhe shërbime gjermane. **Projeksionet për rritje ekonomike në eurozonë nga BQE janë rishikuar në shtator kundrejt projeksioneve të qershorit, në 0.7 përqind për vitin 2023 dhe 1.0 përqind për vitin 2024.** Perspektiva për ekonominë e eurozonës mbetet e pasigurt, si pasojë e tensioneve gjeopolitike dhe dinamikave në ekonominë globale si në kontekst të kërkesës së përgjithshme ashtu edhe të çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare. **Shkalla e inflacionit në TM3 2023 arriti në 4.9 përqind, një ngadalësim i dukshëm krahasuar me shkallën prej 9.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.** Megjithatë shkalla e inflacionit u ngadalësua ndjeshëm në tetor, në takimin e mbajtur më 26 tetor 2023, BQE vendosi të mbajë të pandryshuara normat e interesit. Normat ende të larta të interesit pritet të peshojnë mbi rritjen ekonomike në muajt e ardhshëm, duke dekurajuar kërkesën për huamarrje dhe investime. **Vlerësimet e BQE-së sugjerojnë për ngadalësim të inflacionit në 5.6 përqind në 2023 dhe 3.2 përqind në vitin 2024.**

Grafik 1. Rritja ekonomike dhe inflacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor (TM3 2023)



Burimi: Agjencitë Statistike përkatëse.

Vendet e Ballkanit Perëndimor në tremujorin e tretë të vitit 2023 vlerësohet të kenë shënuar rritje ekonomike prej 3.3 përqind. Rritja ekonomike kryesisht u mbështet nga rritja e kërkesës së brendshme, me Malin e Zi që shënoi rritjen më të lartë ekonomike në rajon prej 6.6 përqind, ndjekur nga Serbia dhe Shqipëria me rritje prej 3.6 respektivisht 3.5 përqind, ndërsa Kosova shënoi rritje ekonomike prej 3.0 përqind. Projeksionet e FMN-së në tetor sugjerojnë se rajoni pritet të shënojë një rritje mesatare ekonomike prej 2.5 përqind në vitin 2023 dhe 3.2 përqind në 2024. Rritja ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor është vlerësuar se do të ndikohet si nga presionet e jashtme (ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në eurozonë) ashtu edhe nga efektet e brendshme (çmimet ende të larta dhe rritja e kostos së financimit).


Shkalla mesatare e inflacionit në TM3 2023 në vendet e rajonit rezultojnë të ketë qenë 6.2 përqind, me shkallën më të lartë të shënuar në Serbi prej 11.4 përqind, ndërsa Kosova rezultojnë të ketë shënuar normën më të ulët të inflacionit prej 3.2 përqind (grafik 1).

2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare vazhduan lehtësimin në TM3 2023 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak si rezultat i stabilizimit të ofertës dhe rrugëve tregtare, dhe ndikimit të shtrëngimit të kushteve të financimit në kërkesën globale. Ndërsa, në krahasim me tremujorin paraprak indeksi i çmimeve të mallrave bazë sipas Bankës Botërore shfaq prirje ngritëse nxitur nga ngritja e çmimeve të energjisë që neutralizoi lehtësimet në çmimet e mallrave tjera jo-energjetike. Çmimet e mallrave bazë parashihet të ndjekin prirje rënëse bazuar në ngadalësimin e aktivitetit ekonomik global që rëndon veçanërisht mbi çmimet e energjisë dhe metaleve, si dhe mbështetur nga oferta stabile dhe ndikimi i limituar i tensioneve gjeopolitike në Evropë dhe në Lindjen e Mesme.

Çmimi i naftës së papërpunuar brent sipas Bankës Botërore arriti mesatare prej \$86.8 për fuçi në TM3 2023, duke shënuar rënie prej 12.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kur çmimet e naftës ishin afër niveleve të tyre më të larta (grafik 2). Ndërsa, në raport me tremujorin paraprak kur ishte evidentuar rënie e çmimit të naftës (\$78.2 për fuçi në TM2 2023), në TM3 2023 çmimet e naftës shënuan ngritje prej 10.9 përqind si pasojë e rritjes së shqetësimeve rreth tkurrjes së ofertës globale të naftës pas njoftimit të Arabisë Saudite dhe Rusisë për zgjatjen e reduktimit të prodhimit prej 1 milion fuçi në ditë (mf/d) respektivisht 0.3 mf/d deri në fund të vitit, që rezultoi në rritje të çmimit në \$94.0 për fuçi në fund të shtatorit. Sipas Bankës Botërore, mesatarja e çmimit të naftës për vitin 2024 parashihet të jetë rreth \$81 për fuçi. Sidoqoftë, ky parashikim përcjellet nga rreziqe për lartë si reduktimi potencial i sasisë së prodhimit të naftës nga vendet eksportuese, tensionet gjeopolitike të intensifikuara me konfliktin në Lindjen e Mesme, e të tjera; ndërsa ngadalësimi i aktivitetit ekonomik global, dhe kërkesa më e ulët për naftë veçanërisht në Kinë, pritet të mbështesin lehtësimin e çmimeve të naftës.

Grafik 2. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Banka Botërore.


Çmimet e gazit natyror në Evropë në TM3 2023 ranë në \$10.8/mmbtu, duke rezultuar kështu në rënie vjetore prej 82.1 përqind kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit të kaluar kur çmimi i gazit natyror në Evropë arriti nivelet më të larta pasi Rusia ndërpreu eksportin e gazit natyror në Evropë (grafik 2). Rënia e çmimeve të gazit natyror në Evropë në TM3 2023 u atribuohet importit të gazit natyror të lëngshëm nga SHBA-të që zbuloi shqetësimet rreth sigurisë së furnizimit si dhe masave të ndërmarra nga BE për rritje të efikasitetit dhe kursim të energjisë. Ndryshe nga TM2 2023 kur çmimet e gazit ndoqën trajektore rënëse, dinamikat brenda tremujorit të tretë shfaqën prirje rritëse si pasojë e pengesave në ofertën e gazit natyror të lëngëzuar (GNL), dhe më vonë konfliktit në Lindjen e Mesme që ndikoi në rritjen e mëtejshme të çmimeve të gazit natyror në \$14.5/mmbtu në tetor dhe nëntor 2023.

Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve shënoi rënie prej 2.2 përqind krahasuar me tremujorin paraprak si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik global, aktivitetit të dobët të sektorit të patundshmërive në Kinë, si dhe stabilizimit të ofertës pas rënies së çmimeve të energjisë (grafik 3). Ndërsa, krahasuar me TM3 2022, indeksi i çmimeve të metaleve shënoi rritje prej 0.2 përqind mbështetur nga rimëkëmbja në sektorë tjerë të ekonomisë së Kinës. Indeksi i çmimeve të metaleve të çmuara ishte 13.2 përqind më i lartë në TM3 2023 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, në raport me tremujorin e kaluar ky indeks shënoi

rënie prej 2.6 përqind. Çmimet e arit shënuan rënie prej 2.5 përqind kundrejt tremujorit paraprak si rezultat i pritjeve për norma të larta të interesit për periudhë më të gjatë dhe rivlerësimit të dollarit amerikan që zbutën kërkesën për ari si aset për shmangje të rrezikut. Ngjashëm rënie u shënuar edhe në çmimet e argjendit dhe platinës prej 2.6 përqindësisht 9.3 përqind, megjithëse kërkesa industriale për këto produkte mbeti e qëndrueshme.


Çmimet e ushqimit në TM3 2023 sipas indeksit të FAO-s shënuan rënie prej 2.0 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, me të gjitha kategoritë që shënuan rënie përveç vajrave që shënuan rritje prej 3.3 përqind. Po ashtu, trend rritës u evidentua në çmimet e sheqerit në shtator pas rënies së çmimeve në korrik dhe gusht 2023 (grafik 4). Në raport me TM3 2022 çmimet e ushqimit shënuan rënie vjetore prej 11.4 përqind nxitur nga rënia e dukshme e çmimeve të vajrave dhe bulmetit (-22.3 përqind), drithërave (-14.4 përqind) dhe mishit (-4.8 përqind), ndërsa çmimet e sheqerit shënuan rritje vjetore prej 37.3 përqind. Lehtësimet në çmimet e ushqimit pritet të vazhdojnë edhe përgjatë vitit 2024 bazuar në pritjet për rritje të rendimentit dhe stabilizim të ofertës.

Grafik 3. Çmimet e metaleve dhe mineraleve dhe metaleve të çmuara



Burimi: Banka Botërore.

Grafik 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit




Burimi: FAO.

3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Rritja Ekonomike

Aktiviteti ekonomik në Kosovë vlerësohet se ka shënuar rritje reale prej 3.0 përqind në TM3 2023. Rritja më e ngadalësuar e aktivitetit ekonomik krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, i'u atribua pasojave nga shkalla ende e lartë e inflacionit dhe rritjes së normave të interesit. Sidoqoftë, rritja e gjeneruar e aktivitetit ekonomik i është atribuuar kontributit pozitiv të konsumit dhe investimeve prej 4.0 përkatësisht 1.0 pikë përqindje. Në anën tjetër, eksportet neto kontribuuan negativisht në rritjen reale të BPV-së me 2.0 pikë përqindje (grafik 5).

Grafik 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë




Burimi: ASK dhe Ilogaritjet e BQK-së.

Konsumi shënoi rritje prej 5.0 përqind në TM3 2023, që është një rritje më e lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e konsumit mund të shpjgohet përmes rritjes së kredive konsumuese, remitençave, kompensimit të punëtorëve, konsumit publik, si dhe ngadalësimit të rritjes së çmimeve të konsumit. Investimet shënuan rritje prej 2.8 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve publike. Për sa i përket tregtisë së jashtme, eksportet neto thelluan deficitin tregtar për 12.8 përqind në TM3 2023. Rritja e deficitit tregtar i'u atribua rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve prej 2.5 përqind (importi i mallrave shënoi rënie prej 1.4 përqind, ndërsa importi i shërbimeve shënoi rritje prej 15.5 përqind), si dhe rënies së eksportit të mallrave dhe shërbimeve prej 0.5 përqind (eksporti i mallrave shënoi rënie prej 7.0 përqind, ndërsa eksporti i shërbimeve shënoi rritje prej 0.9 përqind).

Rritja e aktivitetit ekonomik në TM3 2023 është mbështetur kryesisht nga rritja e vlerës së shtuar në sektorin e aktivitetëve financiarë dhe të sigurimit (5.1 përqind), sektorin e industrisë përpunuese (3.2 përqind), bujqësisë (3.4 përqind), tregtisë (2.9 përqind), etj. Të dhënat e qarkullimit të bizneseve konfirmojnë këtë rritje, ku qarkullimi në sektorin e tregtisë ka shënuar rritje prej 6.7 përqind, në sektorin e industrisë përpunuese 8.3 përqind, etj. Sektori i aktivitetëve financiarë dhe të sigurimit ka shënuar një rritje të dukshme prej 12.7 përqind.

Aktiviteti ekonomik u reflektua në rritjen e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara, që arriti në 2,852 ndërmarrje në TM3 2023, një rritje prej 4.8 përqind krahasuar me TM3 2022. Sektori i tregtisë, aktivitetëve profesionale, informacionit dhe komunikimit, si dhe aktivitetëve të patundshmërisë shënuan numër më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara. Këta sektorë treguan një rritje të ndjeshme në numrin e ndërmarrjeve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 (grafik 6). Në anën tjetër, gjatë TM3 2023, u mbyllën 376 ndërmarrje, apo 1.1 përqind më shumë krahasuar me TM3 2022.

Grafik 6. Numri i ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK.


Vlerësimet e BQK-së për TM4 2023 sugjerojnë për një rritje prej 4.4 përqind, duke bërë që viti 2023 të përmbillet me nivel të rritjes së BPV-së prej 3.4 përqind. Investimet e përgjithshme, konsumi, si dhe eksporti i shërbimeve, i ndërlidhur me shpenzimet e diasporës, vlerësohet se ishin shtytësit kryesor të rritjes, ndërsa vlerësimet për rënie të eksportit të mallrave pritet të ndikojnë negativisht aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, për shkak të strukturës aktuale të ekonomisë.

3.2. Çmimet

Shkalla mesatare vjetore e inflacionit në TM3 2023 u ngadalësua në 3.2 përqind nga 4.2 përqind sa ishte në tremujorin paraprak si rezultat i efektit të bazës dhe lehtësimeve në çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare. Në terma vjetorë, ngadalësimi i inflacionit u mbështet nga rritja e ngadalësuar e çmimeve të ushqimit, rënia e çmimeve të karburanteve dhe zbutja e presioneve inflacioniste në shërbime, ndërsa çmimet e mallrave tjera kontribuuan pozitivisht në përsheptimin e inflacionit (grafik 7).

Çmimet e ushqimit shënuan rritje mesatare vjetore prej 5.5 përqind në TM3 2023, që paraqet ngadalësim kundrejt rritjes vjetore prej 9.7 përqind në tremujorin paraprak. Rritja më e lartë vjetore u evidentua në çmimet e i) perimeve (25.3 përqind), ii) pemëve (11.3 përqind), iii) prodhimeve ushqimore dhe iv) sheqerit, reçelit, mjaltës, çokolllatave dhe ëmbëlsirave (të dy kategoritë me rritje prej 9.6 përqind). Në anën tjetër, u evidentua ngadalësim krahasuar me TM2 2023 në çmimet e pemëve dhe prodhimeve ushqimore, dhe rënie në çmimet e vajrave dhe yndyrave dhe perimeve. Ndërsa, u evidentuan presione inflacioniste kundrejt tremujorit paraprak në çmimet e bukës dhe drithërave, bulmetit, dhe sheqerit dhe produkteve të tij. Përkundër rënies/ngadalësimit në disa artikuj ushqimorë, çmimet e ushqimit mbeten pothuajse 30 përqind mbi nivelet e tyre para fillimit të luftës në Ukrainë, duke vazhduar të rëndojnë mbi të ardhurat e disponueshme të ekonomive familjare marrë parasysh peshën e ushqimit në shportën e konsumit në vend (32.2 përqind).

Grafik 7. Kontributi i nëngrupeve përkatëse në IÇK



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Çmimet e transportit shënuan rënie vjetore prej 3.7 përqind në TM3 2023 me nënkategorinë e përdorimit të pajisjeve për transport personal që regjistroi rënie vjetore prej 10.2 përqind si rrjedhojë e efektit të bazës dhe rënies së çmimeve të karburanteve në tregjet ndërkombëtare krahasuar me vitin e kaluar. Në anën tjetër në terma tremujorë, rritja e çmimeve të karburanteve në tregjet ndërkombëtare në TM3 2023 ndikoi që çmimet e karburanteve në vend të shënojnë rritje prej 6.7 përqind krahasuar me tremujorin paraprak.


Kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit në TM3 2023 ishte 2.0 pikë përqindje, me kontributin më të lartë të shënuar nga rritja e çmimeve të perimeve me 0.6 pikë përqindje, bukës dhe drithërave prej 0.5 pikë përqindje, mishit prej 0.3 pikë përqindje, e të tjera. Ndërsa, kontributi i transportit në inflacionin e përgjithshëm në TM3 2023 arriti në -0.7 pikë përqindje (nga -1.5 pikë përqindje në TM2 2023), i përcaktuar kryesisht nga nënkategoria përdorimi i pajisjeve për transportin personal ku përfshihen karburantet. Kontributi i çmimeve të mallrave tjera jo energjetike shënoi ngritje prej 0.1 pikë përqindje duke arritur në 1.1

pikë përqindje në TM3 2023 krahasuar me tremujorin paraprak bazuar në rritjen e çmimeve të automjeteve, qëndrueshmërinë e çmimeve të duhanit dhe pijeve alkoolike, pajisjeve shtëpiake, e të tjera. Ndërsa, kontributi mesatar tremujor i shërbimeve në gjithsej IÇK-në u zvogëlua në 0.8 pikë përqindje (nga 1.1 pikë përqindje në TM2 2023) falë ngadalësimit të çmimeve të shërbimeve të transportit, shërbimeve hoteliere, atyre për mirëmbajtjen e zakonshme të shtëpisë, e të tjera.

Inflacioni bazë në TM3 2023 shënoi rritje vjetore prej 3.8 përqind, që kundrejt tremujorit paraprak paraqet ngadalësim prej 0.8 pikë përqindje si rezultat i ngadalësimit të presioneve inflacioniste në shërbimet e transportit, atyre hoteliere, si dhe ngadalësimit vjetor të çmimeve të orendive, pajisjeve shtëpiake dhe mirëmbajtjes së shtëpisë (grafik 8). Ndërsa, rritje u evidentua në çmimet e pajisjeve mjekësore dhe shërbimeve ambulante mjekësore.


Varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike, si dhe shkalla e lartë e pjesëmarrjes së këtyre mallrave në shportën e konsumit, ndikojnë që shkalla e inflacionit në Kosovë të përcaktohet në masë të madhe nga çmimet e mallrave të importuara. Në TM3 2023, 2.3 pikë përqindje të inflacionit në Kosovë ishte importuar, ndërsa 0.9 pikë përqindje u gjenur nga presionet e brendshme inflacioniste (grafik 9).

Grafik 8. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Grafik 9. Inflacioni i brendshëm dhe i importuar



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Pasqyrimi i ecursisë së çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare në çmimet e importit në Kosovë përmbledhet përmes indeksit të çmimeve të importit (IÇIMP) i cili në TM3 2023 shënoi rritje vjetore prej 3.0 përqind, që paraqet ngadalësim kundrejt rritjes vjetore prej 4.2 përqind në TM2 2023. Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, kategoritë me peshën më të lartë në kuadër të këtij indeksi që përfshijnë i) artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhanin, dhe ii) pajisjet e makinerisë dhe ato elektrike shënuan rritje vjetore prej 8.9 përqind dhe 3.3 përqind respektivisht, ndërsa i) metalet bazë dhe artikujt përkatës dhe ii) produktet minerale shënuan rënie vjetore prej 5.1 respektivisht 6.0 përqind. Ndërsa, në raport me

tremujorin paraprak, IÇIMP shënoi rritje prej 0.6 përqind, kryesisht si pasojë e përshpejtimin të vazhdueshëm të çmimeve të produkteve minerale dhe artikujve ushqimorë të përgatitur.

Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) rezultoi në rënie prej 12.6 përqind në TM3 2023 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak kryesisht si rezultat i rënies së çmimit të prodhimit të i) energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimit me ajër të kondicionuar (-44.9 përqind), ii) metaleve (-2.4 përqind), si dhe ngadalësimit të çmimeve të komponentëve tjerë me peshë të konsiderueshme në IÇP si prodhimit të produkteve të gomës dhe plastikës, dhe produkteve minerale jometalike.

Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN) në TM3 2023 shënoi rënie vjetore prej 1.5 përqind, nxitur nga rënia e çmimeve të materialeve ndërtimore (-2.0 përqind), energjisë (-44.9 përqind) dhe transportit (-8.1 përqind). Në anën tjetër, në raport me TM2 2023 u evidentua rritje e IKN prej 0.7 përqind kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore, si komponenta me peshën më të lartë në IKN, si dhe rritjes së pagave dhe kostove tjera; ndërsa u evidentua rënie në çmimet e makinerive, transportit, dhe energjisë.


Lidhur me perspektivën e inflacionit në Kosovë, BQK parashikon që inflacioni në vitin 2024 të ngadalësohet në 3.0 përqind. Faktorët që pritet të kontribuojnë në këto dinamika përfshijnë stabilizimin e ofertës dhe çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, trendin zbritës të inflacionit në eurozonë, transmetimin e shtrëngimit të kushteve të financimit në kërkesën e brendshme, e të tjera. Sidoqoftë, rreziqet e ndërlidhura me inflacionin anojnë nga kahu i lartë dhe kryesisht përbëhen nga rreziqet për pengesa në zinxhirët e furnizimit si pasojë e konfliktit në Lindjen e Mesme, luftës në Ukrainë, reduktimin e sasisë së prodhimit nga OPEC+, e të tjera.

3.3. Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore¹ vetëm në TM3 2023 arritën vlerën neto 761.3 milionë euro, duke paraqitur një rritje vjetore prej 6.8 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore² shënuan rritje prej 13.8 përqind dhe arritën vlerën 677.7 milionë euro. Përkundër rritjes më të lartë të shpenzimeve buxhetore krahasuar me të hyrat, Buxheti i Kosovës regjistroi bilanc pozitiv prej 83.6 milionë euro.

Të hyrat tatimore arritën vlerën 683.9 milionë euro, duke shënuar rritje prej 8.4 përqind krahasuar me TM3 2022. Gjatë kësaj periudhe, pothuajse të gjitha kategoritë e tatimeve shënuan rritje. Rritja më e lartë u evidentua tek të hyrat tatimore direkte, të cilat shënuan rritje prej 17.1 përqind dhe arritën vlerën 115.1 milionë euro. Rritja e të hyrave tatimore direkte që kryesisht realizohen nga Administrata Tatimore e Kosovës, ishte rezultat i përmirësimit të procesit të mbledhjes së të hyrave, aktiviteteve të ndërmarra për luftimin dhe parandalimin e evazionit tatimor dhe forcimit të përmbushjes vullnetare nga ana e tatimpaguesve. Brenda kësaj kategorie, tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore, shënoi rritje vjetore prej 16.4 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje vjetore prej 16.8 përqind. Të hyrat tatimore indirekte shënuan rritje prej 7.5 përqind, duke arritur vlerën 585.6 milionë euro. Rritja e të hyrave tatimore indirekte, që paraqet kategorinë kryesore të të hyrave buxhetore, ndër tjera kishte të bënte

Grafik 10. Struktura e të hyrave tatimore



Burimi: MFPT dhe kalkulimet e BQK-së.

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen pranimet nga financimi si dhe pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim si dhe pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

edhe me normën e lartë të inflacionit, e cila edhe pse është ulur ndjeshëm vazhdon të mbetet e lartë. Në kuadër të tatimeve indirekte, të hyrat nga TVSH-ja dhe detyrimi doganor shënuan rritje prej 8.6 përkatësisht 17.8 përqind, duke u ndikuar dukshëm nga rritja e çmimeve. Në anën tjetër, tatimi i akcizës shënoi rritje të ngadalësuar prej 2.8 përqind, si rezultat i ngadalësimit të rritjes së importit të mallrave (grafik 10). **Përveç të hyrave tatimore, edhe të hyrat jo-tatimore shënuan rritje prej 8.1 përqind dhe arritën vlerën 77.3 milionë euro.** Në këtë kategori, të hyrat nga qeveria qendrore arritën vlerën prej 43.5 milionë euro duke shënuar rritje prej 5.0 përqind, ndërsa të hyrat nga qeveria lokale shënuan rritje për 22.1 përqind dhe arritën vlerën 15.7 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje për 9.3 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale shënuan rritje për 43.6 përqind. Në kategorinë e shpenzimeve rrjedhëse, shpenzimet për paga shënuan rritje prej 30.4 përqind dhe arritën vlerën 194.1 milionë euro, shpenzimet për mallra dhe shërbime, përfshirë shpenzimet komunale, shënuan rritje prej 31.3 përqind dhe arritën vlerën 100.0 milionë euro, ndërsa shpenzimet për subvencione dhe transfere shënuan rënie prej 7.2 përqind dhe arritën vlerën 270.5 milionë euro. Shpenzimet kapitale shënuan rritje prej 43.6 përqind duke arritur vlerën 113.1 milionë euro.


Raporti i borxhit ndaj BPV-së u ul në 16.8 përqind në TM3 2023, krahasuar me 20.5 përqind në TM3 2022. Kjo ulje rezultoi nga përmirësimi i bilancit buxhetor të qeverisë dhe rritja e BPV-së nominale, e cila zvogëloi raportin e borxhit ndaj BPV-së. Në terma absolut, borxhi publik ishte 1.62 miliardë euro në TM3 2023, duke treguar rënie prej 4.2 përqind krahasuar me TM3 2022. Zvogëlimi i borxhit publik ishte rezultat i uljes së borxhit të brendshëm publik për 13.4 përqind, duke arritur në 965.1 milionë euro, ndërsa borxhi i jashtëm publik shënoi rritje prej 13.6 përqind dhe arriti në 655.7 milionë euro.

Borxhi i jashtëm publik përfshin detyrimet ndaj Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (37 përqind), Bashkimit Evropian (15 përqind), Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (14 përqind), Fondit Monetar Ndërkombëtar (7 përqind), etj. Në anën tjetër, borxhi i brendshëm përfshin kryesisht borxhin e Qeverisë së Kosovës ndaj fondeve pensionale (47 përqind), bankave komerciale (23 përqind), institucioneve publike (22 përqind), etj.

3.4. Sektori i jashtëm

Llogaria rrjedhëse vetëm në TM3 2023 ka arritur në 223.3 milionë euro (121.9 milionë euro në periudhën TM3 2022). Dinamikat në llogarinë rrjedhëse në periudhën korrik-shtator të vitit 2023 kanë vazhduar të përcaktohen kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të mallrave, komponentë e cila u përkeqësua nga rënia e eksportit dhe pjesërisht nga rritja e lehtë e importit të mallrave. Ndërkohë, të ardhurat parësore, dytësore dhe shërbimet kontribuan pozitivisht në bilancin e llogarisë rrjedhëse.

Grafik 11. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro




Bilanci tregtar i mallrave në Kosovë në TM3 2023 ka shënuar rritje vjetore të deficitit tregtar prej 6.3 përqind, duke arritur në 1.3 miliard euro (grafik 11). Rënia vjetore e eksportit dhe rritja e lehtë e importit

të mallrave (sasisë së mallrave të importuara) ndikoi dinamikat në këtë komponentë. Ekonomia e Kosovës rezulton të ketë importuar mallra në vlerë prej 1.5 miliard euro, deri sa në të njëjtën periudhë, janë eksportuar mallra në vlerë prej 213.1 milionë euro. Eksportet kanë mbuluar vetëm 13.6 përqind të importeve, respektivisht 1:7.3 raporti tregtar (grafik 12).


Vlera e përgjithshme e eksportit në TM3 2023 ishte 213.1 milionë euro, që përbën rënie prej 10.6 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Struktura e mallrave sipas kategorive mbetet kryesisht e pa ndryshuar, ndërkohë që rënia e eksporteve në TM3 2023 u ndikua kryesisht nga eksporti i metaleve bazë që shënoi rënie vjetore prej 16.3 përqind dhe kategori që arriti vlerën prej 44.7 milionë euro (grafik 13). Kjo dinamikë korrespondon me rënien e çmimeve në tregjet ndërkombëtarë dhe pjesërisht, me dobësimin e kërkesës në tregun e jashtëm (në TM3 2023 është shënuar rënie prej 2.2 përqind e peshës së eksportit të metaleve krahasuar me periudhën e njëjtë e vitit të kaluar). Në rënien e eksportit ndikoi edhe kategoria e produkteve të plastikës dhe gomës (10.5 përqind), që shënoi vlerën prej 28.9 milionë euro (32.3 milionë euro në TM3 2022). Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në TM2 2023 ishin: Ballkani Perëndimor me një pjesëmarrje prej 39.2 përqind e gjithsej mallrave të eksportuara, dhe vendet BE-së prej 32.0 përqind.

Vlera e importit të mallrave në TM3 2023 arriti në 1.5 miliard euro, rritje vjetore prej 3.6 përqind. Rritja e lehtë e importit të mallrave u ndikua nga sasia dhe pesha e përgjithshme, që shënuan rritje vjetore prej 3.8 përkatësisht 7.6 përqind. Struktura e kategorive të mallrave të importuara vazhdon të dominohet nga importi i produkteve minerale, artikujt ushqimorë dhe makineritë përfshirë pajisjet shtëpiake (grafik 14). Pjesëmarrja sipas kategorive kryesore të importit u dominua nga kategoria e mallrave të ndërmjetme prej 47.4 përqind, mallrave konsumuese prej 32.8 përqind, ndërsa pjesëmarrja e mallrave kapitale


Grafik 12. Bilanci tregtar i mallrave



Garfik 13. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Garfik 14. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro




mbetet e ulët, më saktësisht 10.3 përqind e importit të përgjithshëm. Sipas kategorive kryesore ekonomike, mallrat e ndërmjetme shënuan rënie prej 7.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, e ndikuar kryesisht nga dinamikat e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Ndërsa kategoria e mallrave kapitale dhe konsumuese shënuan rritje vjetore prej 20.5 përkatësisht 8.3 përqind e ndikuar kryesisht nga rritja e kërkesës në vend. Rreth 42.2 përqind e importeve të mallrave ka ardhur nga vende të Bashkimit Evropian (659.9 milionë euro), ndër të cilat peshën kryesore vazhdon ta ketë Gjermania me 12.5 përqind të gjithsej importeve. Nga vendet e rajonit, Kosova importoi 15.6 përqind të importit të përgjithshëm apo 243.8 milionë euro. Ndërkohë, importi i mallrave nga Turqia ka arritur shumën prej 193.0 milionë euro apo 12.4 përqind e gjithsej importeve.

Shërbimet kanë vazhduar të rrisin kontributin pozitiv në kuadër të llogarisë rrjedhëse, me një rritje vjetore të bilancit pozitiv prej 16.9 përqind, duke arritur vlerën neto prej 877.6 milionë euro në TM3 2023.

Eksporti i shërbimeve i'u atribua kryesisht rritjes së shërbimeve në kategorinë e udhëtimit prej 17.8 përqind, kategori që arriti vlerën prej 1.1 miliard euro dhe kategorinë e shërbimeve kompjuterike me rritje prej 12.5 përqind që arriti vlerën 70.8 milionë euro (62.9 milionë euro në TM3 2022). Në anën tjetër, rritja e importit të shërbimeve i'u atribua rritjes së shërbimeve të udhëtimit dhe transportit, e që përbejnë 75.8 përqind e gjithsej importit të shërbimeve. **Bilanci i të ardhurave parësore ka arritur në 45.5 milionë euro në TM3 2023, ndikuar nga rritja e të hyrave nga kompensimi i punëtorëve me 16.8 përqind që arritën vlerën neto prej 89.6 milionë euro.** Ndërsa bilanci i të ardhurave nga investimet, kryesisht nga investimet direkte, shënoi vlerën prej 44.3 milionë euro në periudhën korrik-shtator 2023 (107.0 milionë euro në TM3 2022) (grafik 16).


Vlera e remitencave të pranuar gjatë TM3 2023 ka arritur në 374.2 milionë euro, rritje prej 7.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Remitencat e pranuar vazhdojnë të vijnë kryesisht nga

Grafik 15. Bilanci i shërbimeve




Burimi: BQK.

Grafik 16. Bilanci i të ardhurave parësore



Burimi: BQK.

Grafik 17. Remitencat



Burimi: BQK.


Gjermania dhe Zvicra që përbëjnë rreth 55.0 përqind të gjithsej remitencave, e ndjekur nga SHBA-të dhe vendet tjera të eurozonës (grafik 17). Dërgesat e emigranteve sipas kanaleve formale (bankat dhe institucionet tjera) kanë shënuar rritje në vlerë prej 11.5 milionë euro, ndërsa është shënuar rritje prej 13.6 milionë euro në dërgesat përmes kanaleve jo formale. Duke konsideruar që pjesa më e madhe e remitancave të pranuar janë me origjinë nga vendet e eurozonës (rreth 60.0 përqind), ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në eurozonë dhe pasiguritë e rritura mund të kenë implikime mbi këtë të hyrë të rëndësishme për ekonominë e Kosovës.

Investimet e huaja direkte në TM3 2023 rezultojnë të kenë shënuar rënie prej 14.5 përqind, duke arritur vlerën prej 245.2 milionë euro.

Rënia IHD-ve është evidentuar kryesisht në sektorin e patundshmërisë, që u karakterizua me një rënie prej 6.2 përqind dhe arriti vlerën prej 152.9 milionë euro (163.1 milionë euro në TM3 2022). Përderisa sektori i patundshmërisë mbetet sektori kryesor për IHD-të, gjatë periudhës korrik-shtator 2023 është vërejtur rritje e investimeve të huaja direkte në

aktivitetet financiare përfshirë aktivitetet e sigurimit, dhe aktivitetet e xehetarisë përfshirë gurorët. Investimet e huaja direkte të rezidentëve nga Kosova në vendet tjera kanë shënuar rritje prej 49.4 përqind në periudhën korrik-shtator 2023, duke arritur vlerën prej 59.4 milionë euro (39.8 milionë euro në korrik-shtator 2022), investime të destinuar në vendet e rajonit e të orientuara kryesisht në sektorin e patundshmërisë (grafik 18).

Grafik 18. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

4. Sistemi financiar

Sistemi financiar në vend është zgjeruar me ritëm të lartë për të tretin vit me radhë, ndërkohë që rritja në vitin e ardhshëm pritet të jetë subjekt i dinamikave të përgjithshme makroekonomike dhe kapacitetit të ngritjes së fondeve (rritja e depozitave).

Asetet e sistemit financiar në vend në fund të shtatorit 2023 arritën vlerën prej 10.60 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.2 përqind (grafik 19). Të gjithë sektorët përbërës u karakterizuan me rritje të lartë vjetore të aseteve (grafik 19).

Sektori bankar në shtator 2023 përfaqësoi 67.6 përqind të gjithë aseteve të sistemit financiar, duke dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e gjithë sistemit (grafik 19). Sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, fondet pensionale, shënuan rritje të përshpejtuar të aseteve krahasuar me një vit më parë (grafik 19).

Sektorët tjerë, ai mikrofinanciar, i sigurimeve dhe ndihmësve financiar shënuan rritje të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe, por për shkak të peshës së ulët, kishin kontribut të ulët në rritjen e gjithë aseteve të sistemit financiar.


4.1. Sektori bankar

Sektori bankar, në veçanti, dhe sistemi financiar në përgjithësi ishin të ekspozuar ndaj rreziqeve që burojnë nga faktorët e përkeqësuar makroekonomik. Përkeqësimi i situatës gjeopolitike dhe efektet e bartura të inflacionit vazhduan të ndikojnë rritjen ekonomike përgjatë vitit 2023. Politikat e shtrënguara monetare ndikuan në uljen e nivelit të inflacionit, por pasojat e inflacionit të transmetuara në segmentet tjera janë ende aktuale. Inflacioni ka prodhuar efekt negativ në shportën e konsumit, rritje të normave të interesit në kredi, rritje të çmimeve në patundshmëri, tregun e punës – presion në paga; por që këto presione pritet që të jenë më të zbutura në vitin e ardhshëm. Sektori bankar në Kosovë për shkak të peshës, strukturës dhe kompleksitetit të ulët nuk ka ekspozim të lartë me sektorin e jashtëm dhe pasojat potenciale të ndonjë krize apo ngjashëm vlerësohet se nuk do të rrezikonin direkt sektorin bankar. Ndërkohë, efektet negative që burojnë nga dinamikat makroekonomike si rritja ekonomike në eurozonë, shkalla e inflacionit dhe rritja e kostos së financimit kanë ndikim më të drejtpërdrejt në kërkesën e brendshme në Kosovë dhe për pasojë, implikime në dinamikat në sektor bankar.

Asetet


Asetet e sektorit bankar në shtator 2023 arritën vlerën 7.16 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 11.0 përqind, për 1 pikë përqindje më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 20). Kontributin

Grafik 19. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës



Burimi: BQK.

Grafik 20. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje



Burimi: BQK.

kryesor në rritje e kishte zgjerimi i kreditimit si aktiviteti kryesor i sektorit bankar, pasuar nga investimi në letrat me vlerë dhe rritja e mjeteve të mbajtura në bankat tjera. Kurse, zëri i parasë së gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rënie gjatë kësaj periudhe, pasi që bankat orientuan investimet në asete që kanë kthim më të lartë (kreditim dhe letra me vlerë).

Kreditimi


Aktiviteti kreditues i sektorit shënoi rritje vjetore prej 13.3 përqind, që përkon me shkallë më të ulët të rritjes krahasuar me një vit më parë, duke reflektuar ngadalësimin e kreditimit të korporatave jofinanciare. Sipas Anketës së Kreditimit bankar (AKB), dinamikat e kreditimit edhe në tremujorin e tretë të vitit 2023, sikurse gjatë gjithë vitit, u ndikuan nga kërkesa kreditore, ndërkohë që oferta kreditore kishte ndryshime marginale.

Segmenti i korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore të stokut të kredive prej 10.8 përqind, që përkon me ngadalësim vjetor për 7.6 pikë përqindje (grafik 21). Ngadalësim të rritjes së kreditimit kishte për të gjithë sektorët ekonomik, me peshë më të lartë kreditimi ndaj sektorit të tregtisë, prodhimit dhe ndërtimtarisë. Ky zhvillim u ndikua nga oferta kreditore, ku në AKB, bankat deklaruan standarde kreditore të shtrënguara marginalisht për ndërmarrjet e mëdha, ndërsa për NVM-të kishte lehtësim marginal për tremujorin e tretë të vitit. Në kontekst të faktorëve që i ndikuan këto zhvillime, rritja e normës së EURIBOR dhe perspektiva jo e mirë në tregjet globale patën kontribut kryesor negativ në standardet kreditore. Përderisa, mbështetja nga FKGK dhe pozita e favorshme e likuiditetit kishin ndikim pozitiv deri në një masë në standardet kreditore.

Ndërsa, kreditë për ekonomitë familjare ruajtën nivelin e rritjes të një viti më parë, prej 17.3 përqind. Për shkak të peshës më të lartë në gjithsej kreditë, segmenti i korporatave jofinanciare kishte kontributin kryesor në ngadalësimin e përgjithshëm të gjithsej kredive (grafik 23).


Kreditë e reja deri në shtator të vitit 2023 kishin përgjysmim të shkallës së rritjes, në 8.9 përqind nga 16.3 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Segmenti i korporatave jofinanciare u karakterizua me

Grafik 21. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet




Burimi: BQK.

Grafik 22. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Grafik 23. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje



Burimi: BQK.


ngadalësim të normës së rritjes vjetore të kredive të reja, ndërsa ai i ekonomive familjare shënoi rritje të përshpejtuar krahasuar me vitin paraprak (grafik 23).

Kreditë e reja ndaj korporatave jofinanciare u rritën për 8.5 përqind krahasuar me rritjen prej 26.2 përqind deri në shtator të vitit 2022. Kreditë e reja me karakter investues u rritën për 8.4 përqind, si dhe kreditë me karakter jo-investues shënuan rritje vjetore prej 14.0 përqind. Kreditë e reja për ekonomitë familjare shënuan rritje të përshpejtuar vjetore prej 9.5 përqind gjatë kësaj periudhe. Në kuadër të segmentit të ekonomive familjare, kreditë e reja konsumuese shënuan rritje vjetore prej 14.4 përqind, nga rënia prej 2.5 përqind deri në shtator të vitit 2022, ndërsa kreditë e reja hipotekare shënuan rënie vjetore prej 9.2 përqind, për dallim nga rritja prej 8.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Investimet e huaja direkte në sektorin e patundshmërisë gjithashtu treguan tendencë rënëse deri në shtator 2023. Kjo, së bashku me rënien e kredive hipotekare, mund të sugjerojnë për tendencë të rënies së investimeve në patundshmëri, të ndikuar nga rritja e normave të interesit si dhe çmimeve të patundshmërive.

Në kuadër të kredive për korporatat jo financiare, sektori i tregtisë është më i kredituar ndër vite, pasuar nga ai i prodhimitarisë dhe i ndërtimitarisë, të cilët janë zgjeruar gradualisht në vitet e fundit duke rritur pjesëmarrjen në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Në fund të shtatorit 2023, kreditimi ndaj sektorit të tregtisë kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kredive për segmentin e korporatave jofinanciare (grafik 24), si rezultat i peshës së lartë në këtë segment si dhe rritjes vjetore prej 9.3 përqind (grafik 25).


Sektori i prodhimitarisë, që në vitin e kaluar kishte peshën më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit për këtë segment, në shtator 2023 shënoi rritje më të ngadalësuar vjetore prej 11.2 përqind nga 38.1 përqind një vit më parë, kur edhe u mbështet nga masat subvencionuese të qeverisë në kuadër të pakos së ringjalljes ekonomike. Kreditimi ndaj sektorit të ndërtimitarisë shënoi rritje vjetore të përgjysmuar, prej 15.1 përqind në shtator 2023, nga 29.9 përqind një vit më parë. Në ngadalësimin e kreditimit për këtë sektor mund të ketë ndikuar edhe shkalla e lartë e inflacionit në vitin 2022 - rritjes së çmimit të materialeve ndërtimore që

Grafik 24. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 25. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK.

Grafik 26. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK.

janë transmetuar në ngadalësimin e punimeve ndërtimore apo ndërprerjen e përkohshme të tyre. Sektori i bujqësisë, i cili është më së paku i kredituar nga bankat komerciale, u karakterizua me rritje prej 8.2 përqind, për dallim nga rritja prej 4.3 përqind në vitin paraprak.

Detyrimet dhe burimet vetanake

Financimi i aktiviteteve të sektorit bankar vazhdoi të mbështetet nga depozitat e klientëve dhe kapitalit vetanak, konkretisht fitimit të mbajtur nga periudhat paraprake dhe fitimit të realizuar deri në shtator të vitit 2023. Të dy këto zëra përbëjnë 93.2 përqind të detyrimeve dhe ekuitetit, ku 81.7 përqind përbëhen vetëm nga depozitat. Pra, rritja e sektorit bankar në masën më të madhe është e varur prej ecurisë së depozitave, të cilat përcaktojnë kahjen e lëvizjes së sektorit.


Depozitat

Vlera e stokut të depozitave në fund të shtatorit 2023 arriti në 5.85 miliardë euro (grafik 27), që paraqet një rritje vjetore prej 11.3 përqind, nga 12.7 përqind në shtator të vitit 2022. Depozitat e dy segmenteve të sektorit privat shënuan lehtësisht ngadalësim të rritjes, por që kjo rritje më e ulët ishte më shumë i efektit krahasimor të vitit 2022 me 2021, duke qenë se TM3 i vitit 2022 u karakterizua me rritje shumë më të theksuar vjetore që mund të jetë ndikuar nga fillimi i rritjes së normave të interesit në atë periudhë. Për më tepër, depozitat kanë ndjekur trend të rritjes njëtrajtshëm deri në shtator 2023, ku mesatarja e rritjes vjetore të depozitave përgjatë muajve janar-shtator 2023 ishte 15.1% që tejkalon mesataren e rritjes vjetore të depozitave përgjatë vitit paraprak që ishte 9.7%.

Depozitat e mbledhura prej korporatave publike, jorezidentëve dhe OJQ-ve shënuan rritje më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë. Kurse, depozitat e arkëtuara nga korporatat tjera financiare, që kryesisht janë depozita të fondeve pensionale, shënuan rritje të përshpejtuar krahasuar me një vit më parë.


Në shtator 2023, vlera e depozitave të ekonomive familjare arriti në 3.89 miliardë euro, rritje vjetore prej 9.0 përqind nga 11.5 përqind në vitin paraprak, duke përcaktuar kështu edhe trendin e përgjithshëm të gjithsej depozitave në sektorin bankar (grafik 28). Sa i përket nivelit të depozitave të reja të arkëtuara nga ekonomitë familjare, ku përfshihen vetëm depozitat e afatizuara, deri në shtator 2023 arritën vlerën prej 430.9 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 37.3 përqind, më e lartë krahasuar me rritjen vjetore të vitit paraprak prej 22.6 përqind (grafik 29).

Grafik 27. Stoku i gjithsej depozitave



Burimi: BQK.

Grafik 28. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje



Burimi: BQK.

Stoku i depozitave të korporatave jofinanciare në fund të shtatorit 2023 arriti në 1.22 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 14.9 përqind nga 16.2 përqind në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Depozitat e reja të arkëtuara deri në shtator të vitit 2023 nga ky segment u rritën në 186.5 milionë euro nga 121.8 milionë në periudhën e njëjtë të vitit 2022 (rritje vjetore prej 53.1% nga rritja prej 70.0 përqind në periudhën e njëjtë të një viti më parë). Rritja e vazhdueshme e konkurrencës në vend për sigurimin dhe mbajtjen e depozitave nxiti bankat të ofrojnë kushte më atraktive për depozitim të mjeteve kryesisht përmes rritjes së normave të interesit në depozita, ndryshim i cili u reflektua edhe në rritjen e theksuar të depozitave të afatizuara nga të dy segmentet. Në linjë me këto dinamika, rezultatet e AKB-së gjithashtu tregojnë për rritje të qasjes në financim të sektorit bankar përgjatë TM3 2023 krahasuar me tremujorin paraprak, nga të dy segmentet.


Normat e interesit

Banka Qendrore Evropiane nuk ka rritur më tej normat bazë të interesit, e që është tregues i frenimit të inflacionit, i cili pritet të ketë një rritje të lehtë dhe pastaj rënie graduale në vitin 2024, kurse në vitin 2025 pritet të bie në nivelin e rekomanduar (nën 2.0 përqind). Këto zhvillime në politikën monetare të BQE-së mund të ndikojnë edhe në normat e interesit të aplikuara nga bankat vendore, të cilat nëse nuk ulën, pritet që të mos rritën më tej, ashtu siç ndodhi nga gjysma e dytë e vitit të kaluar. Për më tepër, edhe në anketën e fundit të realizuar me bankat, ato nuk presin që ti rrisin normat e interesit.

Normat e interesit në kredi dhe depozita të reja shënuan rritje graduale, që nga fillimi i vitit të kaluar, të nxitura nga aplikimi i politikave të shtrënguara monetare nga bankat qendrore në luftën kundër inflacionit.


Në tregun bankar në Kosovë, normat e interesit në depozitat e reja janë ndikuar në nivel më të lartë se normat e interesit në kredi të reja. Në shtator të këtij viti, norma e interesit në kredi arriti në 6.5 përqind nga 6.3 përqind në shtator 2022. Po ashtu shkalla mesatare e interesit në depozita u ngrit në 2.4 përqind nga 1.9 përqind në shtator 2022. Margjina e interesit kredi-depozitë u ngushtua në 4.08 pikë përqindje nga 4.33 pikë përqindje për shkak të rritjes më të lartë të normës së interesit në depozita krahasuar me ato në kredi (grafik 30).

Grafik 29. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 30. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK.


Grifik 30a. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit



Burimi: BQK.

Dinamika e normave të interesit e ndikuar nga zhvillimet në nivel global, si dhe rritja e rrezikut të likuiditetit dhe pasigurive mbi zhvillimet në të ardhmen si pasojë e rritjes së presioneve inflacioniste, përveç që kanë shtyrë bankat në vend drejtë rritjes së normave të interesit në kredi e depozita, në të njëjtën kohë kanë ndikuar edhe në ndryshimin e strukturës së kredive sipas llojit të normave të interesit. Përderisa në vitin 2019, 2020 dhe 2021, kreditë me norma variabile të interesit, që kryesisht përcaktohen nga lëvizjet e normës Euribor për marzhën shtesë, përbënin mesatarisht 15.9 përqind të portfolios kreditore, 16.8 dhe 19.6 përqind respektivisht, kjo përbërje u rrit vazhdimisht, ku në shtator të vitit 2022 arriti në 24.9 përqind dhe deri në shtator 2023 është ngritur tutje në 32.6 përqind (grafik 30a).


Grifik 31. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare



Burimi: BQK.

Norma mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare në shtator 2023 qëndroi në 6.7 përqind, për 0.2 pikë përqindje më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Norma më të favorshme të interesit në kredi u ofruan për sektorin e shërbimeve prej 6.6 përqind, ndërsa norma më e lartë mesatare e interesit ishte për sektorin e bujqësisë prej 8.3 përqind (grafik 31).

Grifik 32. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Norma mesatare e interesit në kredi ndaj ekonomive familjare arriti në 6.2 përqind, për 0.1 pikë përqindje më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Normat më të favorshme të interesit janë aplikuar për kreditë hipotekare në mesatare prej 5.2 përqind, duke qenë se konsiderohen me rrezik më të ulët kur kanë mbulesë me kolateral (hipotekë). Kurse, kreditë konsumuese vazhdojnë të kenë norma më të larta të interesit prej mesatarisht 6.6 përqind (grafik 32).

Normat e interesit në depozita filluan trendin rritës që nga muaji qershor i vitit 2022. Në shtator 2023 norma mesatare e interesit në depozita arriti në 2.4 përqind, për 0.5 pikë përqindje më e lartë se në shtator 2022. Norma mesatare e interesit në depozita për korporatat jofinanciare është rritur për 0.4 pikë përqindje, në 2.8 përqind. Po ashtu për ekonomitë familjare është rritur për 0.5 pikë përqindje, duke arritur në 2.3 përqind në shtator 2023 (grafik 33).

Performanca e sektorit bankar


Sektori bankar në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023 realizoi profit neto prej 123.7 milionë euro, niveli më i lartë në raport me periudhat e njëjta të viteve paraprake. Rezultati i tillë financiar u arrit kryesisht nga rritja e të hyrave e cila ishte më e larët se një vit më parë, përderisa edhe shpenzimet vazhduan trendin rritës për të dytin vit me radhë (grafik 34).

Gjithsej të hyrat arritën vlerën prej 317.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 17.2 përqind (13.6 përqind deri në shtator 2022). Në rritjen e të hyrave kontributin kryesor e kishin të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 74.0 përqind të gjithsej të hyrave. Në kuadër të të hyrave nga interesi, arkëtimet nga interesi në kredi kontribuuan kryesisht në këtë rritje, kategori e ndikuar prej rritjes së theksuar të kreditimit, posaçërisht në tri vitet e fundit, si dhe rritjes së normave të interesit në kredi. Për më tepër, të hyrat nga plasmanet me bankat janë rritur theksueshëm krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Ndërsa, kategoria e të hyrave nga jo interesi, kryesisht nga tarifat dhe komisionet, shënoi rritje më të ngadalësuar vjetore prej 4.1 përqind nga rritja prej 14.1 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën prej 72.0 milionë euro në fund të shtatorit 2023.


Vlera e shpenzimeve të sektorit bankar arriti në 193.4 milionë euro deri në shtator 2023. Me rritje më të përshpejtuar vjetore u karakterizuan edhe shpenzimet duke u rritur përkatësisht për 18.8 përqind nga 10.0 përqind sa ishte deri në shtator të vitit të kaluar. Kontributin më të lartë në këtë rritje kishte rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative si dhe shpenzimeve të interesit. Kategoria me peshën më të madhe në gjithsej shpenzimet, ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative me pjesëmarrje prej 57.2 përqind, u rritën për 17.5 përqind nga viti paraprak (9.0 përqind rritje në vitin a kaluar); dhe arritën vlerën në 110.6 milionë euro në fund të shtatorit 2023. Rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve të personelit, për të përshtatur nivelin e pagave me ritmin e rritjes së inflacionit. Po ashtu shpenzimet e interesit shënuan rritje vjetore prej 97.4 përqind nga rënia e shënuar në vitin paraprak prej 27.1 përqind, që i atribuohet rritjes së normave të interesit në depozita në veçanti dhe financimit në përgjithësi, si dhe njëkohësisht rritjes së stokut të depozitave.

Grafik 33. Normat e interesit për depozita



Burimi: BQK.

Grafik 34. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.


Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar ndër vite ka arritur të sigurojë nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit, si dhe të mbajë nivel të ulët të kredive jo-performuese. Nivelet e këtyre indikatorëve përtej kërkesave rregullatore i jepin përparësi sektorit në absorbimin e humbjeve të mundshme që do të shkakttoheshin në rast të ndonjë goditje negative makroekonomike dhe financiare.

Cilësia e asetëve, me saktësisht portfolios kreditore shënoi përmirësim duke filluar nga tremujori i fundit i vitit 2021 deri në shtator të vitit të kaluar, ku vlera e kredive jo-performuese kishte trend rënës prej mesatarisht 2.5 përqind. Kurse, që nga tremujori i fundit i vitit 2022 vlera e kredive jo-performuese filloi të rritet; më konkretisht u rrit për 4.3 përqind në fund të vitit 2022 dhe 8.4 përqind në shtator të vitit 2023. Si raport ndaj stokut të kredive, KJP-të u zvogëluan në 2.0 përqind nga 2.1 përqind në shtator të vitit të kaluar, si rezultat i rritjes më të theksuar të kreditimit gjatë kësaj periudhe. Mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë u zvogëlua lehtësisht në 143.5 përqind, nga 150.6 përqind në shtator 2022, për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive jo-performuese se sa i vlerës së provizioneve të ndara për mbulimin e kredive (grafik 35).


KJP-të për segmentin e ekonomive familjare vazhdojnë të jenë të ulëta, prej 1.4 përqind, megjithëse si vlerë janë rritur për 4.7 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Ndërsa për segmentin e korporatave jofinanciare raporti i KJP-ve qëndroi në 2.4 përqind, dhe vlera e KJP-ve shënoi rritje vjetore për 1.4 përqind. Me rritje të vlerës së KJP-ve u karakterizua sektori i energjisë dhe prodhimitarisë, për 3.5 milionë euro dhe 3.7 milionë euro respektivisht, kurse si raport ndaj kredive është rritur për 6.6 pikë përqindje dhe 0.5 pikë përqindje, respektivisht, duke arritur në nivelin 9.1 përqind dhe 1.9 përqind. Vlera e KJP-ve për sektorin e tregtisë u zvogëlua për 2.0 milionë euro, ndërsa si raport ndaj kredive zbriti në 1.8 përqind nga 2.2 përqind. Ndërsa për sektorët e tjerë vlera dhe raporti i KJP-ve pësuan lëvizje marginale krahasuar me vitin paraprak.

Grafik 35. Kreditë jo-performuese dhe mbulueshmëria me provizione




Burimi: BQK.

Grafik 36. Treguesi i solvencës



Burimi: BQK.

Grafik 37. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u zvogëlua për 0.5 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke zbritur në nivelin prej 15.3 përqind. Kjo si rezultat i rritjes më të lartë të mjeteve të peshuara me rrezik për shkak të aktivitetit të rritur kreditor dhe investimeve në letra me vlerë, krahasuar me rritjen relativisht më të ngadalësuar të kapitalit. (grafik 36).

Raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra në shtator 2023 ishte 32.6 përqind, për 2.6 pikë përqindje më e ulët krahasuar me një vit më parë (grafik 37). Rënia e lehtë e raportit të likuiditetit, rezultoi për shkak të rritjes më të theksuar të detyrimeve afatshkurtëra prej 8.0 përqind krahasuar me rritjen e mjeteve likuide prej 0.1 përqind. Kurse, raporti kredi/depozitë është rritur në 81.9 përqind nga 80.4 përqind një vit më parë.


4.2. Sektori pensional

Asetet e sektorit pensional rikthyen ritmin e shpejtuar të rritjes, pas ngadalësimit të theksuar një vit më parë që ishte pasojë e luhatjeve të mëdha në tregjet financiare. Deri në shtator 2023, të dy fondet pensionale shënuan kthim pozitiv nga investimet në tregjet e jashtme dhe rritje të kontributeve të arkëtuara.

Me pjesëmarrjen e dytë më të lartë prej 24.7 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, asetet e fondeve pensionale u rritën për 12.8 përqind në fund të shtatorit 2023, krahasuar me rritjen vjetore prej vetëm 4.2 përqind një vit më parë (grafik 38). Vlera e aseteve pensionale arriti në 2.62 miliardë euro, nga të cilat 99.7 përqind përfaqësohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-ja), dhe pjesa e mbetur nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP-ja). Përderisa FKPK-ja shënoi rritje vjetore të aseteve prej 12.8 përqind, asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP-ja) shënuan rritje vjetore prej vetëm 6.6 përqind.


Asetete FKPK-së janë të investuara kryesisht në tregun e jashtëm (75.5 përqind e portfolios investuese). Invesimet në portfolion e fondeve të përbashkëta arrijnë vlerën prej 1.96 miliardë euro (apo 75.2 përqind e gjithsej aseteve të FKPK-së), ndërsa pjesa tjetër e investimeve është e diversifikuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 454.4 milionë euro apo 17.4 përqind e gjithsej portfolios investuese dhe certifikata të depozitit në sektorin bankar vendor në vlerë prej 122.7 milionë euro apo 4.7 përqind e gjithsej investimeve. Po ashtu edhe struktura e portfolios investuese e FSKP-ës është ngjashëm e diversifikuar me atë të FKPK-së, duke qenë kryesisht e orientuar në tregun e jashtëm, në aksione që përbëjnë 80.7 përqind të portfolios investuese dhe para të gatshme që përbëjnë vetëm 2.2 përqind të gjithsej investimeve. Kurse, investimet brenda vendit janë kryesisht të fokusuar në letra me vlerë të Qeverisë së

Grafik 38. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.

Grafik 38a. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



Burimi: FKPK, FSKP.

Kosovës që përfaqësojnë 14.7 përqind të gjithsej portfolios investuese. Pjesa e mbetur e mjeteve të mbajtura në vend (rreth 2.4 përqind) përbëhet nga paraja e gatshme dhe depozitat e mbajtura në bankat komerciale.

Për dallim nga viti i kaluar, përgjatë këtij viti si FKPK-ja ashtu edhe FSKP-ja kanë rritur investimet në tregun e jashtëm kundrejt zvogëlimit të investimeve në sektorin e brendshëm. (grafik 38a).

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FSKP-ja deri në shtator 2023 arriti në 492.0 mijë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.2 përqind, e ndikuar njëkohësisht nga rritja e numrit të kontribut-dhënësve dhe vlerës së kontributeve (grafik 39a). Kurse, kthimi kumulativ bruto nga investimet deri në shtator 2023 arriti në 413.3 mijë euro krahasuar me humbjet në vlerë prej 895.3 mijë euro një vit më parë, që ishte pasojë e luhatjeve në tregjet financiare.

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK-ja deri në shtator të vitit 2023 shënoi rritje vjetore prej 19.9 përqind, duke arritur në 212.3 milionë euro (grafik 39b). Rritja e lartë dyshifrore e kontributeve të arkëtuara ndër tjerash reflekton edhe rritjen e pagave të shërbyesëve civil, që nga fillimi i vitit 2023. Kurse, kthimi bruto në investime deri në shtator të vitit 2023 arriti vlerën prej 47.6 milionë euro krahasuar me humbjet në vlerë prej 170.5 milionë euro në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Kthimi pozitiv në investime reflekton performancën më të mirë në tregjet financiare globale, veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit.


4.3. Sektori i sigurimeve

Aktiviteti i sektorit të sigurimeve shënoi rritjen më të lartë në pesë vitet e fundit, dhe u karakterizua me rritje të primeve të shkruara, e reflektuar edhe në performancë pozitive financiare. Cilësia e aseteve, kapitalit dhe niveli i kërkesave kyçe rregullatorë mbetet te përmirësohet.

Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.8 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar në fund të shtatorit 2023. Vlera e gjithsej aseteve arriti në 300.7 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 16.1 përqind (grafik 40). Zgjerimi i sektorit kryesisht erdhi si rezultat i rritjes së rezervave teknike, që burojnë nga primet e shkruara si dhe kapitalit vetanak të siguruesëve. Rritje më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara. Kategoria e dytë për nga pesha, ajo e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, shënoi rritje më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë, që përveç tjerash mund të jetë rezultat edhe i ofertës më të ulët të qeverisë për emetim të letrave me vlerë.


Vlera e primeve të shkruara në fund të shtatorit 2023 arriti në 110.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.1 përqind, e ndikuar kryesisht nga rritja e primeve të shkruara të kategorisë ‘sigurimi i shëndetit’ në

Grafik 39a. Performanca e FSKP-së, në milionë euro



Burimi: FSKP.

Grafik 39b. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK.

kuadër të sigurimit vullnetar dhe 'përgjegjësia motorike ndaj palës së tretë' në kuadër të sigurimit të detyrueshëm. Primet e shkruara ndaj sigurimit të detyrueshëm vazhdojnë të kenë peshën më të madhe, prej 58.4 përqind të gjithsej primeve të shkruara jo-jetë. Përveç rritjes së primeve në kuadër të 'sigurimit të shëndetit' prej 14.5 përqind është rritur edhe numri i policave për këtë kategori, në 235.4 mijë nga 183.3 mijë. Ndërsa, rritja e primeve të sigurimit të detyrueshëm reflekton kryesisht kategorinë e 'sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësia - MTPL e brendshme' që shënoi rritje vjetore prej 8.5 përqind.


Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve deri në shtator 2023 arriti vlerën prej 53.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.0 përqind (2.2 përqind një vit më parë) (grafik 41). Vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 21.9 përqind. Rritja më e theksuar e dëmeve të paguara buroi nga segmenti 'jo-jetë', përkatësisht dëmeve të 'sigurimit nga zjarri dhe forcat e natyrës' dhe 'sigurimit të shëndetit'. Megjithëse kategoria e 'përgjegjësia motorike ndaj palëve të treta' vazhdon të ketë peshën më të madhe prej 56.8 të gjithsej dëmeve të paguara nga segmenti 'jo-jetë', rritje vjetore prej vetëm 1.9 përqind nuk i peshoi dëmet e paguara aq sa kategoritë tjera. Sektori i sigurimeve deri në shtator të vitit 2023 realizoi fitim në vlerë prej 9.4 milionë euro (2.8 milion euro në periudhën e njëjtë të një viti më parë). Vlera më e lartë e fitimit të realizuar erdhi si rezultat i vlerës më të lartë të të hyrave të arkëtuara nga primet e shkruara krahasuar me vlerën e shpenzimeve për dëmet e paguara dhe shpenzimeve tjera operative.

Perkunder arritjes së kërkesave rregullatorë, cilësia e aseteve dhe kapitalit mbetet të përmirësohet, sikurse edhe niveli i kërkesave kyçe rregullatorë si solvenca dhe asetet në mbulim të provizioneve.

4.4. Sektori mikrofinanciar


Sektori mikrofinanciar shënoi rritje të përshpejtuar, kryesisht ndikuar nga zgjerimi i kreditimit dhe lizingjeve, si dhe rritjes së kapitalit vetanak. Sektori realizoi fitim pothuajse të ngjashëm me vitin paraprak, ndërsa ruajti cilësinë e portfolios kreditore dhe siguroi nivele të larta të provizionimit të kredive jo-

Grafik 40. Asetet e sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK.

Grafik 41. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

Grafik 42. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

performuese. Financimi i aktivitetit nga huamarrjet në sektorin e jashtëm e bën sektorin mikrofinanciar më të ndjeshëm ndaj dinamikave në tregjet e jashtme. Për pasojë rritja e normave të interesit në nivel global ka ndikuar koston e financimit të institucioneve mikrofinanciare më theksueshëm, se të bankave të cilat bazën financuese e kanë kryesisht nga depozitat e brendshme.


Asetet

Vlera e aseteve të sektorit mikrofinanciar arriti në 479.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 25.1% në shtator 2023 (grafik 42). Në këtë rritje kontributin kryesor e kishte rritja e kreditimit dhe në masë më të ulët rritja e lizingjeve. Aktiviteti kreditor i sektorit vazhdon të mbështetet nga huazimet (linjat kreditore) jashtë vendit të cilat u rritën për 29.2 përqind. Po ashtu, kontribut në rritjen e aktivitetit të sektorit kishte edhe rritja e nivelit të kapitalit, nga fitimi i bartur dhe atij të realizuar.

Kreditë


Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar vazhdoi të rritet me ritëm të përshpejtuar për të tretin vit me radhë, duke arritur vlerën prej 339.7 milionë euro, që paraqet rritje vjetore për 25.0 përqind.

Grafik 43. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare




Burimi: BQK.

Grafik 44. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.

Grafik 45. Kontributi në rritje të kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.

Të dy segmentet e sektorit privat, korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare, u karakterizuan me rritje. Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 20.5 përqind (14.8 përqind në shtator 2022), duke arritur vlerën 212.0 milionë euro (grafik 43), ndërsa stoku i kredive ndaj korporatave jo financiare arriti vlerën prej 127.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 33.3 përqind (22.7 përqind në shtator 2022). Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare ka ndjekur trendin rritës në të gjithë sektorët ekonomik (grafik 44). Për dallim nga sektori bankar, stoku i kredive ndaj segmentit të bujqësisë ka peshën më të madhe prej 25.4 përqind, në gjithësej kreditimin e korporatave jofinanciare nga institucionet mikrofinanciare.

Po ashtu, ky segment kishte edhe kontributin më të lartë në rritjen e kreditimit ndaj korporatave jofinanciare (grafik 45), duke shënuar rritje vjetore prej 28.2 përqind në shtator 2023 vlera e të cilës kategori arriti në 32.4 milionë euro. Megjithatë, mikrofinancat mbeten një instrument i rëndësishëm për qasje në financa për kategori të caktuara, ndërsa burimet financimit dhe kostoja mbetet një sfidë. Rritja e kreditimit për segmentin e bujqësisë përveç tjerash është mbështetur edhe nga garancioni kreditor i FKGG-së.

Lizingjet

Lizingjet vazhdojnë të jenë kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar (19.4 përqind). Aktiviteti i lizingjeve shënoi rritje vjetore prej 29.6 përqind, vlera e të cilave arriti në 92.8 milionë euro (grafik 46). Në rritjen e lizingjeve kontributin kryesor vazhdojnë ta kenë korporatat jofinanciare, përderisa kontributi i lizingjeve për ekonomitë familjare ishte më i ulët.


Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga mikrofinancat ishte 18.9 përqind, për 0.2 pikë përqindje më e lartë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 47). ato janë shoqëruar me trend rënës përkundër që zhvillimet e fundit të rritjes së normave të interesit në nivel global, janë reflektuar në koston e financimit të sektorit, që është bartur pjesërisht në rritje të normave të interesit në kredi.

Norma e interesit për kreditë e ekonomive familjare shënoi rritje për 0.9 pikë përqindje, në 21.8 përqind. Norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese është rritur për 3.3 pikë përqindje në 24.6 përqind ndërsa e kredive hipotekare është rritur për 2.0 pikë përqindje duke arritur në mesatare prej 18.9 përqind.


Për korporatat jofinanciare, normë mesatare e interesit, u zvogëlua për 0.4 pikë përqindje, në 15.7 përqind (grafik 48). Norma e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë dhe atij të industrisë u rritën për 0.1 dhe 0.8 pikë përqindje përkatësisht, duke arritur në 18.1 përqind dhe 17.4 përqind respektivisht. Kurse, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve është 14.9 përqind, që ruajti nivel pothuajse të njëjtë me vitin paraprak.

Grafik 46. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Grafik 47. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Grafik 48. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

Performanca e sektorit mikrofinanciar


Sektori mikrofinanciar deri në shtator 2023 shënoi fitim neto në vlerë prej 12.8 milionë euro, e që është për 0.7 milionë euro më i ulët se në periudhën e njëjtë të një viti më parë (grafik 49).

Rritja më e theksuar e shpenzimeve për 30.8 përqind, krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të të hyrave për 19.1 përqind, ndikuan që sektori të ketë performancë financiare më të ulët se një vit më parë.

Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi, që paraqesin kategorinë dominuese të të hyrave (90.3 përqind), shënuan rritje vjetore prej 20.6 përqind (16.3 përqind deri në shtator 2022), që është rezultat i rritjes së theksuar të kreditimit. Kategoria e të ardhurave nga jointerisi shënoi rritje vjetore prej 6.8 përqind (rritje për 6.0 përqind një vit më parë), si rezultat i rritjes së kategorisë së të ardhurave nga tarifat dhe komisionet.


Në kuadër të shpenzimeve, rritja kryesisht i'u atribuua shpenzimeve nga jointerisi, të cilat u rritën për 30.6 përqind (17.2 përqind një vit më parë), dhe arritën vlerën në 20.7 milionë euro, kryesisht nga rritja e shpenzimeve të personelit dhe administrative. Kjo nënkategori shënoi rritje vjetore prej 19.4 përqind (20.3 përqind një vit më parë), duke arritur vlerën në 19.6 milionë euro në fund të periudhës. Ndërsa, kategoria e shpenzimeve të interesit (26.3 përqind të gjithsej shpenzimeve) shënoi rritje të theksuar vjetore prej 56.0 përqind (2.8 përqind një vit më parë) duke arritur vlerën në 9.6 milionë euro. Rritja e shpenzimeve të interesit ka reflektuar rritjen e nivelit të huazimeve nga sektori i jashtëm, dhe rritjes së kostos së këtyre huazimeve. Niveli i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive u zvogëlua lehtësisht 1.9 përqind nga 2.1 përqind një vit më paë. Niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në shtator 2023 është rritur në 145.1 përqind nga 144.0 përqind në shtator 2022) (grafik 50).

Grafik 49. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Grafik 50. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë




Burimi: BQK.

4.5. Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës


Vlera e emetuar e borxhit deri në shtator të vitit 2023 ishte pothuajse përgjysmë më e ulët se sa në periudhën e njëjtë të një viti më parë.

Grafik 51. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 51a. Shuma e ofruar dhe emetuar




Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Për dalim nga vitet paraprake, në tremujorin e tretë të këtij vitit nuk ishte realizuar ndonjë emetim i borxhit. Megjithatë, kërkesa për të investuar në letra me vlerë ka vazhduar të tejkalojë ofertën e qeverisë.

Borxhi i emetuar arriti vlerën prej 76.8 milionë euro, që është për 58.2 përqind më e ulët se një vit më parë (grafik 51). Ndërsa, kërkesa e akterëve në treg për të investuar në letra me vlerë ka tejkaluar ofertën e qeverisë për 1.22 herë, lehtësisht më e lartë se në vitin paraprak ku kërkesa ishte 1.19 herë më e lartë (grafik 51a).

Investuesit kryesor në borxhin e qeverisë janë fondet pensionale, që përbëjnë 63.4 përqind të stokut të borxhit qeveritar, pasuar nga bankat komerciale me 29.9 përqind, dhe pjesa e mbetur nga kompanitë e sigurimit. Deri në shtator 2023, stoku i letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës të mbajtur nga bankat, fondet pensionale dhe kompanitë e sigurimit kishte vlerën prej 718.7 milionë euro (872.1 milionë euro në shtator të vitit të kaluar). Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit ndër vite ka pësuar ndryshime graduale, duke u zgjeruar drejt afateve më të gjata të maturimit. Në periudhën janar-shtator 2023, struktura u dominua nga fletë-obligacionet qeveritare me maturitetet prej '5 viteve' dhe '3 viteve', që kanë pjesëmarrje të njëjtë prej 32.6 përqind, pasuar nga pjesa e mbetur që përfaqësohet nga fletë-obligacionet qeveritare me maturitetet '2-vjeçar' (grafik 52).

Grafik 52. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Investuesit kryesor në borxhin e qeverisë janë fondet pensionale, që përbëjnë 63.4 përqind të stokut të borxhit qeveritar, pasuar nga bankat komerciale me 29.9 përqind, dhe pjesa e mbetur nga kompanitë e sigurimit. Deri në shtator 2023, stoku i letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës të mbajtur nga bankat, fondet pensionale dhe kompanitë e sigurimit kishte vlerën prej 718.7 milionë euro (872.1 milionë euro në shtator të vitit të kaluar). Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit ndër vite ka pësuar ndryshime graduale, duke u zgjeruar drejt afateve më të gjata të maturimit. Në periudhën janar-shtator 2023, struktura u dominua nga fletë-obligacionet qeveritare me maturitetet prej '5 viteve' dhe '3 viteve', që kanë pjesëmarrje të njëjtë prej 32.6 përqind, pasuar nga pjesa e mbetur që përfaqësohet nga fletë-obligacionet qeveritare me maturitetet '2-vjeçar' (grafik 52).

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 44, TM3 2023, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK:

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

ASK:

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat ë tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

Të tjera:

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org)
- d) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Të dhënat nëntëmujore mbi borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/5dd2850a-be21-4e50-8860-9df088b1c540.pdf>
- e) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Raport Nëntëmujor Financiar, Buxheti i Republikës së Kosovës: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/6d90a295-b45d-42c7-9982-242354d26b5a.pdf>

Euribor: Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

ECB (BQE): Economic Bulletin Research & Publications (europa.eu)

IMF (FMN): World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](http://imf.org)

World Bank: Commodity Markets: [Commodity Markets \(worldbank.org\)](http://worldbank.org)



Rr. Garibaldi, nr. 33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web:www.bqk-kos.org